



Datë: 24.02.2026
Numër Protokolli: 980/2026

A.nr.63/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.63/2026, të datës 22.01.2026, të parashtruar nga ankuesi E.P, kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të ndryshuar dhe plotësuar më Ligjin Nr.08/L-180, me datë 24.02.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.63/2026 e datë 22.01.2026 e parashtruar nga ankuesi E.P.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, E.P (*tutje referuar ankuesja*), më datë 22.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se pas ndryshimit të Rregullores nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor përmes Rregullores nr.05/2025 të miratuar nga KGJK me datë 24.07.2025 më është ulë pozita nga drejtues i mesëm në drejtues i ultë nga data 01.01.2026.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të SKGJK ndërsa, kjo e fundit më datë 10.02.2026, ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave tutje referuar Kolegji i Këshillit, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 343/2026 të datës 22.01.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër Ds-549/2025 datë 22.07.2025 dhe Akt emërimit Ds-2013/2025 datë 19.12.2025; Kopjen letërnjoftimit; Përgjigjen në ankesë të datë 10.02.2026 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme P.A.nr.20/2025.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pa bazuar, **sepse**;

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë se ankuesi, sipas Akt emërimit Ds-2013/2025 datë 19.12.2025 në Gjykatën Themelore në Ferizaj në pozitën Udhëheqës i Zyrës për Bugjet dhe Financa në Klasën Drejtues i Ultë, ndërsa ankuesi deri me hyrjen në fuqi të Rregullores nr.03/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor kishte akt emërimit Drejtues i mesëm.

Ankuesi në ndërlidhur me atë që u tha më lartë ka parashtruar ankesë në KPMSHCK me pretendimet për dëmtim financiar për shkak të uljes në pozitë, por ankuesi nuk është lëshuar fare në përmendjen e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme P.A.nr.20/2025 sipas të cilit Gjykata Supreme ka vendosur lidhur me ligjshmërinë e Rregullores nr.03/2025 me të cilën është ndryshuar Rregullorja nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor dhe sipas këtij aktgjykimi, Gjykata Supreme ka lënë në fuqi Rregulloren nr.03/2025.

Kolegji i Këshillit konstaton se Gjykata Supreme në Aktgjykimin P.A.nr.20/2025 në faqen 26, 27 dhe 28 të këtij aktgjykimi ka shkruar fjalë për fjalë citojmë “Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit në Gjykatën Supreme të Kosovës, ishin pretendimet e paditësve përkitazi me ligjshmërinë e dispozitës së aktit nënligjor të kontestuar, përkatësisht nenit 11 të Rregullores Nr.03/2025, e cila përcakton pozitën e paditësve në “drejtues i ulët”, ku theksi i pretendimeve të paditësve, ndër të tjerat vihet në: ndryshimin e pozitave të tyre nga “drejtues i mesëm” në “drejtues i ultë”, i cili sipas tyre është ndryshim i padrejtë dhe i pajustificuar, pretendimi për dëm në dy drejtime: diskriminim krahas pozitave të tjera ekuivalente dhe dëmtim material për shkak të koeficientit të ulët (8.6 në vend të 9.4); akti kontestues shkel Ligjin e Punës, Ligjin për Pagat dhe aktet nën ligjore të mëparshme; ndryshimi në nivelin “drejtues i ultë I” iu pamundëson përfitimin e rritjes së koeficientit nga 8.6 në 9.4; e paditura ka paraqitur tre argumente për ulje në pozitë : provimi i jurisprudencës, numëri i bartësve dhe raportimi vetëm të administrator i gjykatës, të cilat paditësit i konsiderojnë të paqëndrueshme; pozitave të tyre janë ekuivalente me ato të zyrës për Menaxhimin e Lëndëve dhe Zyrës për Mbështetje Juridike dhe janë të vendosura në të njëjtën linjë raportuese dhe përgjegjësisë në organogramin e Gjykatës. Rregullorja Nr.03/2025 është një akt nën ligjor normative i cili është nxjerr në përputhje me ligjin dhe aktet kushtetuese që rregullojnë këtë fushë, përfshirë dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-055, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjit Nr.08/L-197, për Zyrtarët Publik, Ligjit për Pagat Nr.08/L-197 në Sektorin Publik, si dhe aktgjykimeve: Nr.KO216/22, KO220/22 dhe KO79/23 të Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës, duke respektuar pavarësinë funksionale dhe organizative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Neni 108 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, garanton pavarësinë dhe autonomin e KGJK-së në ushtrimin e funksioneve të saj, përfshirë administrimin gjyqësor, punësimin dhe mbikëqyrjen, hartimin e buxhetit dhe sistematizimin e pozitave brenda gjyqësorit. Ky parim I pavarësisë garanton që vendimet e KGJK-së, mbi klasifikimin e pozitave nuk mund të vihen në diskutim në bazë të pretendimeve subjektive të paditësve për trajtim të pabarabartë. Ndërsa, sipas nenit 42 të Ligjit Nr.08/L-196, për Pagat në Sektorin Publik, përcaktohet se krijimi I funksioneve, pozitave dhe emërtimeve të reja në institucionet e pavarura kushtetuese, duke përfshirë sistemin e drejtësisë, rregullohet me akt të veçantë nga organet kompetente të institucioneve.

Në këtë kontekst, Gjykata e Supreme vlerëson se klasifikimi i pozitive të paditësve është kryer në përputhje me mandatet kushtetuese dhe ligjore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë sistematizimin e pozitive. Ndarja e pozitive drejtuese, përfshirë paditësit është bërë për arsye teknike dhe organizative, duke marrë parasysh numrin e përgjegjësive, kompleksitetin e detyrave dhe numrin e vartësve nën mbikëqyrje, dhe nuk ka prekur në asnjë mënyrë pagën, koeficientin apo të drejtat e tjera të paditësve. Pozitat e paditësve nuk janë ekuivalente me pozitat e udhëheqësve të zyrave për menaxhimin e lëndëve ose mbështetje juridike, sepse përgjegjësit, kompleksiteti dhe niveli i llogaridhënies janë të ndryshme, gjë që justifikon ndarjen dhe klasifikimin e tyre të veçantë”.

Andaj nisur nga ajo që është përshkruar më lartë dhe në dritën e thënieve në aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Kolegji i Këshillit duke u mbështetur në Ligjin Nr.06/L-048 për KPMSHCK respektivisht nenin në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

KËSHILLË JURIDIKE: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS LËNDA , A.nr.63/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.P;
- SKGJK-së ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.